

Vendim nr. 155 datë 04.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 04.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARDI LATE**, përfaqësuar nga avokatët Nertila Qordja dhe Artan Shllaku, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 4675, datë 22.12.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-5231, datë 14.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, paragrafi 2, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6, paragrafi 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ardi Late ka qenë me detyrë specialist në seksionin e rendit dhe të sigurisë së objekteve në Komisarjatin e Policisë Vlorë, pranë Drejtorisë së Policisë Vlorë, ndërsa ka mbajtur gradën “Nënkomisar”. Në datat 17 dhe 27 tetor 2011 ndaj kërkuesit është filluar ecuria disiplinore për dy raste, për të cilat janë konstatuar shkelje gjatë ushtrimit të detyrës. Rasti i parë lidhet me faktin se kërkuesi në datën 13.10.2011, ndërsa ka qenë i planëzuar me shërbim në turnin e tretë, pa vënë në dijeni eprorët, është larguar nga shërbimi për rreth 1 orë e 30 minuta, duke marrë dhe drejtuar vetë mjedin e policisë dhe në vijim, kur është konstatuar nga eprorët i ndaluar paralel me një mjet pa targën e pasme, është larguar menjëherë. Ndërsa rasti i dytë lidhet me faktin se kërkuesi, në datën 22.10.2011, ndonëse ishte planëzuar me detyrë sigurimin e rendit gjatë zhvillimit të një ndeshjeje futbolli, nuk është paraqitur në detyrë dhe nuk u është përgjigjur thirrjeve të eprorëve të tij në telefon.

2. Në përfundim të ecurisë disiplinore është hartuar raporti përfundimtar nr. 2297/1 prot., datë 11.11.2011, në të cilin është arritur në konkluzionin se nga kërkuesi janë kryer shkeljet disiplinore “Kryerja e veprimeve të pahijshme” dhe “Shkelja ose mosushtrimi i kompetencave të policisë”, sipas neneve 11, pika 5 dhe 12 të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr. 786, datë 04.06.2008 të Këshillit të Ministrave. Në vijim, ndërsa kërkuesi ka qenë i ndëshkuar për mungesën e disiplinës në punë edhe më parë, Drejtori i Policisë Vlorë, me shkresën nr. 2297/2 prot., datë 11.11.2011, i ka propozuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhënien ndaj kërkuesit të masës disiplinore “Përrjashtimi nga Policia e Shtetit”. Me vendimin nr. 82, datë 11.11.2011 (*vendim nr. 82/2011*), drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka vendosur përjashtimin e kërkuesit nga Policia e Shtetit. Mbi ankimin administrativ të kërkuesit, Komisioni i Apelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me vendimin nr. 18, datë 06.02.2012, e ka konsideruar të motivuar masën disiplinore të dhënë ndaj tij. Më tej, me urdhrin nr. 255, datë 20.02.2012, (*urdhri nr. 255/2012*), drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka urdhëruar përjashtimin e kërkuesit nga Policia e Shtetit dhe ndërprerjen e të drejtave financiare në datën 23.02.2012.

3. Në datën 11.09.2012 kërkuesi ka paraqitur padi me objekt konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 82/2011 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, shfuqizimin e urdhrin të tij nr. 255/2012 dhe detyrimin e të paditurve të rregullojnë pasojat e ardhura nga largimi

i menjëhershëm dhe i pajustificuar nga puna. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11283, datë 11.11.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuarit. Në vijim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1179, datë 03.04.2014, ka shpallur moskompetencën e saj, duke ia dërguar aktet gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 2940 datë 10.07.2014, ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndërsa ka konstatuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore.

4. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7087, datë 03.12.2014, ka deklaruar moskompetencën e saj tokësore, duke ia dërguar aktet gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 331, datë 12.03.2015, ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuarit dhe urdhëruar: (i) detyrimin e të paditurve, Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë (*DPQ, Vlorë*) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*), t'i paguajnë paditësit (kërkuarit) si dëmshpërblim pagën e 12 muajve, për shkak të përjashtimit të paligjshëm nga Policia e Shtetit; (ii) shfuqizimin e vendimit nr. 82/2011 dhe të urdhrit nr. 255/2012 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si të paligjshëm; (iii) rrëzimin e kërimit në padi për kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4675, datë 22.12.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuarit. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5231, datë 14.11.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në ballafaqim me parashikimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (para ndryshimeve me ligjin nr. 39/2017) (*ligji nr. 49/2012*), si dhe të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit, shkaqet në përmbajtjen e rekursit të kërkuarit nuk janë të tilla që bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Në datën 07.05.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuessit

7. **Kërkuessi** ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për seancën gjyqësore në adresën elektronike të avokatëve të tij, në zbatim të parashikimeve procedurale civile, ndonëse këto të dhëna janë vendosur në dispozicion. Në këtë mënyrë kërkuessit i është mohuar e drejta për të paraqitur pretendime me shkrim dhe e drejta për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues që ka gjykuar themelin e çështjes. Në këtë drejtim, atij i është cenuar edhe *parimi i paanshmërisë*, pasi një nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka shprehur mendime që i ka përsëritur edhe në arsyetimin e vendimit të kolegut të kërkuessit, shtetasit D.Xh., çka përbën argument për paragjykimin e çështjes. Gjykata e Lartë në atë rast ka mbajtur qëndrim të gabuar, për të cilin Gjykata ka konstatuar cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për çështjen e kërkuessit ekzistonin shkaqet për shqyrtimin me përparësi të çështjes, për shkak të specifikës së saj.

7.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë e ka arsyetuar qëndrimin e saj në disa paragrafë, të cilët, për më tepër, paraqesin mospërputhje mes faktit të pretenduar dhe pasojës që ka përcaktuar ligji. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar në lidhje me argumentet mbi të cilat është bazuar për të rrëzuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Lartë, në mënyrë të gabuar, është shprehur se kërkuessi nuk ka parashtruar në mënyrë të qartë në rekurs shkaqet ligjore dhe cilat janë shkeljet e rënda procedurale të vendimit të gjykatës së apelit. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit, pra nuk ka analizuar dhe vlerësuar pozitën dhe të drejtat e kërkuessit në raport me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është në kundërshtim me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 01.07.2011 (*vendimi unifikues nr. 7/2011*), si dhe me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 276, datë 07.05.2015. Kjo gjykatë duhet të merrte në konsideratë pasojat e ardhura nga zgjidhja e paligjshme e kontratës së shërbimit publik, duke vendosur dëmshpërblimin e kërkuessit me 12 paga bazuar në vendimin unifikues, pasi punonjësve të policisë të përjashtuar nuk u njihet e drejta e rikthimit në detyrë, por vetëm ajo e dëmshpërblimit.

7.3. Po në këtë drejtim, vendimi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit është në kundërshtim me ligjin, pasi asnjë nga shkeljet e konstatuara nuk përbën shkelje të rëndë disiplinore konform rregullores së disiplinës në punë. Në këtë drejtim nuk është respektuar parimi i proporcionalitetit midis shkeljes së pretenduar dhe masës disiplinore konkrete. Po ashtu, vendimi i Komisionit të Apelimit nuk është nënshkruar nga dy prej anëtarëve, për rrjedhojë është absolutisht i pavlefshëm. I tillë është edhe vendimi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili ka urdhëruar përfundimisht përjashtimin e kërkuesit nga Policia e Shtetit. Gjithashtu, këto vendime janë në kundërshtim me ligjin edhe për faktin se 4 ditë përpara marrjes së vendimit për përjashtimin, kërkuesi është transferuar në një sektor tjetër më të rëndësishëm, duke u ngritur në detyrë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 4, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimin për pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkak se nuk është nënshkruar nga dy prej anëtarëve, kërkuesi e ka ngritur vetëm në rekursin para Gjykatës së Lartë, por jo në kërkesëpadi dhe në ankimin në gjykatën e apelit. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 43 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim, ai nuk ka shteruar mjetet juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 14.11.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është dërguar në Gjykatë, përmes shërbimit postar, në datën 07.05.2024. Nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton se Gjykata e Lartë e ka informuar kërkuenin se vendimi është zbardhur në datën 08.01.2024. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se ai legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me parimin e paanshmërisë dhe standardin e arsytimit të vendimit. Për sa i përket këtij të fundit, ndër të tjera, kërkuesi ka pretenduar se vendimet administrative të përjashtimit të kërkuemit nga Policia e Shtetit janë në kundërshtim me ligjin, pasi masa nuk është proporcionale. Kolegji vlerëson se ky argument ka të bëjë në thelb me mënyrën e vlerësimit të provave për zbatimin e ligjit, çështje që për nga natyra e tyre nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit

kushtetues. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera, ato *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me parimin e paanshmërisë

14. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për seancën gjyqësore në adresën elektronike të avokatëve të tij, në zbatim të parashikimeve procedurale civile, ndonëse këto të dhëna janë vendosur në dispozicion. Në këtë mënyrë, kërkuesit i është mohuar e drejta për të paraqitur pretendime me shkrim dhe e drejta për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues që ka gjykuar themelin e çështjes. Në këtë drejtim, atij i është cenuar edhe *parimi i paanshmërisë*, pasi një nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka shprehur mendime që i ka përsëritur edhe në arsyetimin e vendimit të kolegut të kërkuesit, shtetasit D.Xh., çka përbën argument për paragjykimin e çështjes. Gjykata e Lartë në atë rast ka mbajtur qëndrim të gabuar, për të cilin Gjykata ka konstatuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për çështjen e kërkuesit ekzistonin shkaqet për shqyrtimin me përparësi të çështjes, për shkak të specifikës së saj.

15. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka evidentuar rëndësinë e së drejtës për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, e cila u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Për sa i takon procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 17, datë 01.03.2017; nr. 29, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po kështu, Gjykata ka pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shihet që bëhet (*shih vendimet nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga kërkuesi nëpërmjet rekursit, i cili është regjistruar në datën 11.01.2017. Nga përmbajtja e materialeve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual nuk rezulton që ai të ketë deklaruar ose të ketë bërë të njohur për gjykatën një adresë të postës elektronike (*e-mail*) për qëllime të marrjes së njoftimeve edhe në rrugë elektronike, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së ose pikës 5 të urdhrin nr. 131, datë 02.07.2021 të Gjykatës së Lartë “Për publikimin e datave të gjyqimeve dhe njoftimin e palëve”. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të publikuara nga Gjykata e Lartë, në rubrikën “*Çështje të ardhura*”, rezulton e publikuar se kjo çështje është shpallur në datën 30.10.2023 për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 14.11.2023, ora 09:45.

18. Nga sa më lart, nisur nga fakti se rekursi është paraqitur nga vetë kërkuesi, i cili ka detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së tij dhe njoftimi i shqyrtimit të rekursit është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, Kolegji vlerëson se argumentet që atij nuk i është komunikuar informacioni për përbërjen e trupit gjykues, datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe vendimi i arsyetuar, janë të pamjaftueshme për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit.

19. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë, kërkuesi ka pretenduar se një nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka shprehur mendime që i ka përsëritur edhe në arsyetimin e vendimit të kolegjit të kërkuesit, shtetasit D.Xh., çka përbën argument për paragjykimin e çështjes. Kolegji çmon se ky pretendim nuk përbën argument në mbështetje të cenimit të parimit të paanshmërisë, për sa kohë që çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, në varësi të rrethanave dhe faktorëve, të cilat nuk mund të jenë të njëjta. Në rastin konkret konstatohet se vendimi i Gjykatës së Lartë, i referuar nga kërkuesi, përmban rrethana dhe palë të ndryshme, të cilat kanë specifikat e tyre, çka do të thotë se mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit vlerësohet nga gjykata e zakonshme në kontekst të fakteve dhe

provave të çështjes konkrete dhe shprehja e mendimit në atë vendim nuk mund të përbëjë paragjykim të çështjes së kërkuesit.

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me parimin e paanshmërisë është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit

21. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka arsyetuar qëndrimin e saj në disa paragrafë, të cilët, për më tepër, paraqesin mospërputhje mes faktit të pretenduar dhe pasojës që ka përcaktuar ligji. Sipas tij, ajo gjykatë nuk ka arsyetuar në lidhje me argumentet mbi të cilat është bazuar për të rrëzuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, por në mënyrë të gabuar është shprehur se kërkuesi nuk ka parashtruar në mënyrë të qartë në rekurs shkaqet ligjore dhe cilat janë shkeljet e rënda procedurale të vendimit të gjykatës së apelit. Po kështu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit, pra nuk ka analizuar dhe vlerësuar pozitën dhe të drejtat e kërkuesit në raport me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 7/2011, si dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Ajo gjykatë duhet të merrte në konsideratë pasojat e ardhura nga zgjidhja e paligjshme e kontratës së shërbimit publik, duke vendosur dëmshpërblimin e kërkuesit me 12 paga bazuar në vendimin unifikues, pasi punonjësve të policisë të përjashtuar nuk u njihet e drejta e rikthimit në detyrë, por vetëm ajo e dëmshpërblimit.

22. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje mbi një padi të kërkuarit, në të cilën ka kërkuar konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 82/2011 dhe shfuqizimin e urdhrin nr. 255/2012 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe detyrimin e të paditurve të rregullojnë pasojat e ardhura nga largimi i menjëhershëm dhe i pajustificuar nga puna. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke shfuqizuar si të paligjshme dy aktet e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe detyruar të paditurin të dëmshpërblejë paditësin (kërkuarin) me 12 paga mujore për shkak të përjashtimit të paligjshëm nga Policia e Shtetit. Ajo gjykatë ka arsyetuar se urdhri i punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në thelb, është një veprim tjetër administrativ i organit të administratës shtetërore, ndaj, me daljen e ligjit nr. 49/2012, vendimi unifikues nr. 7/2011 i Gjykatës së Lartë ka humbur aktualitetin. Në vijim, sipas gjykatës, veprimi tjetër administrativ i ndërmarrë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit (me cilësinë e punëdhënësit) është i paligjshëm, pasi asnjë nga veprimet e kryera nga paditësi (kërkuari) nuk përbën shkelje të rëndë të përfshirë në termat "veprime të pahijshme" apo "shkelje ose mosushttrim i kompetencave të policisë" dhe nga këto shkelje të konstatuara nuk ka ardhur asnjë pasojë e rëndë. Për rrjedhojë, arsyeton gjykata, masa disiplinore e përjashtimit të paditësit nga policia nuk është në proporcion të drejtë me shkeljen e konstatuar. Në kushtet kur përjashtimi nga Policia e Shtetit është bërë jashtë kriterëve ligjore, paditësit i lind e drejta e trajtimit financiar për të kompensuar dëmin nga zgjidhja e kontratës së punës, i cili, sipas gjykatës, duhet të përcaktohet në masën e 12 pagave mujore (*shih faqet 7-12 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë*).

24. Në të kundërt të këtij qëndrimi, gjykata e apelit ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material. Për sa i përket pretendimit për konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 82/2011 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kjo gjykatë ka vlerësuar se nuk gjendet në asnjë prej rasteve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, ndërsa për pavlefshmërinë relative të urdhrin të drejtorit të përgjithshëm, ajo e ka konsideruar si një kërkim të paraqitur jashtë afatit ligjor. Gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkitimi i padisë për shfuqizimin e urdhrin nr. 255/2012 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit është i pambështetur në ligj referuar edhe vendimit unifikues nr. 7/2011. Ky i fundit ka përcaktuar se pala që dëmtohet nga një pushim i padrejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit dhe punëmarrësi nuk mund të ngrejë padi për goditjen e aktit administrativ, por mund të ngrejë padi për kërkitimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e

kontratës së punës. Në lidhje me shkeljet e kryera nga kërkuesi ajo gjykatë ka pranuar se ndonëse ato mund të mos jenë të një natyre të tillë që përlligj masën e përjashtimit nga policia, në kushtet kur janë dy shkelje të përsëritura, masa është e motivuar dhe e mbështetur në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Rregulloren e Disiplinës së Policisë së Shtetit. Duke qenë se aktet objekt gjykimi janë të vlefshme, atëherë pretendimi i paditësit për dëmshpërblim në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk qëndron. Në përfundim gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë (*shih faqet 19-24 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

25. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Ajo ka arsyetuar se është detyrë e rekursuesit të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse nga gjykata është zbatuar gabim ligji material apo procedural, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Sipas saj, nëse shkaqet ligjore nuk parashtrohen dhe të argumentohen sipas kërkesave të ligjit, ajo është e detyruar të vendosë mospranimin e rekursit. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se përfundimet në të cilat ka arritur gjykata e apelit, nuk janë kundërshtuar në rekursin e kërkuesit, ndaj arsyetimi dhe konkluzionet e arritura prej saj mbeten të pakundërshtuara ligjërisht. Gjithsesi, sipas saj, gjykata e apelit nuk rezulton të ketë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, të mos ketë garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes apo të mos ketë sqaruar rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Kjo gjykatë ka pranuar arsyetimin e gjykatës së apelit për sa i përket moslejimit të rikthimit në Policinë e Shtetit të punonjësve të përjashtuar për shkelje të rënda disiplinore. Në lidhje me ligjshmërinë e urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Gjykata e Lartë ka çmuar se nuk janë ngritur shkaqe në rekurs që të bëjnë të mendohet se gjykata e apelit ka vlerësuar gabimisht thelbin e mosmarrëveshjes dhe bazueshmërinë në ligj të akteve administrative objekt padie (*shih paragrafët 37-42 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

26. Nga përmbajtja e vendimeve të lartpërmendura Kolegji vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat u kanë dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve të tij lidhur me natyrën juridike të marrëdhënies së punës me Policinë e Shtetit. Kështu, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka vlerësuar se në kushtet kur aktet për përjashtimin nga policia janë të vlefshme edhe pretendimi për dëmshpërblim është i pabazuar, duke referuar ndër të tjera edhe vendimin

unifikues nr. 7/2011. Në këtë drejtim, Kolegji çmon se, ndonëse me arsyetim të kufizuar, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kundërthënie dhe të mos ketë respektuar standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton që interpretimi i ligjit të ketë qenë arbitrar e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.